



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1123 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 116, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC- 1 Vranisht, HEC- 2 Strojan, HEC- 3 Hoçisht, HEC- 4 Grapsh, HEC- 5 Ziçisht" Korçë* - subjekti "Begem Energji", sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC- 1 Vranisht, HEC- 2 Strojan, HEC- 3 Hoçisht, HEC- 4 Grapsh, HEC- 5 Ziçisht" Korçë* - subjekti "Begem Energji", sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova.
2. Subjekti duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për ndërtimin e "HEC- 1 Vranisht, HEC- 2 Strojan, HEC- 3 Hoçisht, HEC- 4 Grapsh, HEC- 5 Ziçisht" Korçë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO